



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo administracija lokalne samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 11.08.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, NR.7/01, Mars 2019), si dhe Shtojcën I-(9) të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, nxjerr:

V E N D I M

1. Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për projekte/programet të organizatave jo-qeveritare në fushën e Auditimit social në nivel lokal, në kuadër të sistemit të menaxhimit të performancës komunale dhe grantit të performancës.
2. Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Mbështetje financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MAPL-së kodit i organizatës buxhetore 212 në kandër të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transfere - kodi ekonomik 21200, dhe do të shpërndahen në bazë të dokumentacionit për zbatimin e kësaj thirrje publike, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Thirrje publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MAPL-së: <https://mapl.rks-gov.net/>.
5. Në përputhje me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, MAPL do të themelojë një Komision Vlerësues për vlerësimin dhe përzgjedhjen e

një OJQ-je, për zbatimin e Auditimit social në nivel lokal e cila i përmbushë me sukses të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë thirrje.

6. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
7. Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit.

Jeton Qela


Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- *Ministrit të MAPL-së;*
- *DBF në MAPL;*
- *Arkivit në MAPL.*